

VENDIM
Nr. 565, datë 4.10.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE PERONDI, FSHATI TAPI, KUÇOVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike të njësisë administrative Perondi, fshati Tapi, Kuçovë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kuçovë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 673 696 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 673 696 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, përballohet nga Bashkia Kuçovë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Kuçovë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Kuçovë.

8. Bashkia Kuçovë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kuçovë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Kuçovë

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi, në favor të Bashkisë Kuçovë.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kuçovë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kuçovë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE
SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE
TË NJËSISË ADMINISTRATIVE PERONDI, FSHATI TAPI, KUÇOVË”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA KADASTRALE								VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM					SHËNIME (kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)	
												ARË			Vlerat e kulturave bujqësore dhe druftorë sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë	VLERA TOTAL E (lek)		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Vlera e kulturave bujqësore (lek)	Vlera e druftorëve (lek)		
1	Bekdash	Yzeir	Troka	Tapi	3561	1280/55	Arë	560	560	4	21	560	311	174 160		120 000	294 160	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Behar	Yzeir	Troka	Tapi	3561	1280/53	Arë	472	472	4	19	472	311	146 792			146 792	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Nebi	Yzeir	Troka	Tapi	3561	1280/56	Arë	560	560	4	22	560	311	174 160		58584	232 744	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Nazire	Ionus	Troka	Tapi														
																	673 696	